



## Procesi KOMRA

### Raport

### Shtator 2012 – tetor 2014

Në periudhën e vëzhguar, Koalicioni për KOMRA<sup>1</sup> ka realizuar rezultate mbi ato të priturat dhe të planifikuarat. Aksionet publike *KOMRA për të ardhmen*, *KOMRA për të ardhmen e të rinjve*, *Vrapoj për KOMRA-n* dhe *E përkrah KOMRA-n* kanë treguar se qytetarët nga vendet post-jugosllave e përkrahin nismën për KOMRA, para së gjithash sepse është me karakter rajonal, pastaj për shkak të qëllimeve dhe të detyrave qartë të përcaktuara e, po ashtu, edhe ngaqë vjen nga niveli lokal; Shoqata „Drejtësia Tranzicionale, Përgjegjësia dhe Kujtimi në B dhe H“ (DTPKBH) dhe Qendra për Demokraci dhe Drejtësi Tranzicionale (QDDT) së bashku punojnë në realizimin e projektit *Vënia në hartë e kampeve në B dhe H*, që drejtpërdrejt i kontribuon përmbushjes së detyrës së KOMRA-s që të regjistrojë të gjitha kampet në luftërat në periudhën kohore 1991-2001; komuniteti i artistëve është bërë promotor i vlerave të bashkëndjesisë si parakusht i afritit, i respektimit, i besimit dhe i pajtimit në Ballkan; avokuesit publik të Nismës për KOMRA ia kanë dalë që presidentët e Kroacisë, të Serbisë, të Kosovës, të Malit të Zi dhe të Maqedonisë si dhe dy anëtarë të Presidencës së B dhe H të emërojnë të dërguarit e tyre personal për KOMRA-n. Në atë takim të të dërguarve, të mbajtur në datën 6 shtator të vitit 2013, të dërguarit i kanë dhënë përkrahje të parezervuar neneve 13 dhe 14 të Propozim Statutit të KOMRA-s, të cilin e ka përpiluar Koalicioni rajonal. Në takimin tjetër, të mbajtur në datën 27 tetor të vitit 2013, të dërguarit e kryetarëve të shteteve të vendeve të rajonit i kanë shqyrtuar për KOMRA-n në mënyrë të hollësishtme nenet deri te kapitulli i shtatë i Propozim Statutit të KOMRA-s dhe i kanë parashtruar mendimet e tyre në lidhje me kompetencat e KOMRA-s, zgjedhjen e panelit përzgjedhës, periudhën e veprimit dhe të hulumtimit, afatet e caktuara dhe çështjet e tjera në lidhje me mundësitë juridike dhe kushtetuese për themelimin e KOMRA-s.<sup>2</sup>

Përveç kësaj, Koalicioni në masë të madhe është rritur në periudhën e vëzhguar – ai tash numëron 1,982 anëtarë. Është fjala për koalicionin me numrin më të madh për drejtësinë tranzicionale, i cili ka kapacitete që shteteve të rajonit të ish-Jugosllavisë t’iu ndihmojë në formimin e KOMRA-s dhe në zbatimin e mandatit në vepër, që ka të bëjë me regjistrimin e viktimave civile dhe ushtarake,

<sup>1</sup> Koalicioni për KOMRA tubon rreth vetes pothuajse 2000 organizata të shoqërisë civile, individë, femra e meshkuj, nga të gjitha vendet post-jugosllave të cilat e avokojnë themelimin e Komisionit Rajonal për Vërtetimin e Fakteve mbi krimet e luftës dhe shkeljet e tjera të rënda të kryera në territorin e ish RSFJ në periudhën prej vitit 1991 deri në vitin 2001.

<sup>2</sup> Takimi i radhës është planifikuar për muajin janar të vitit 2014, kur do të bëhet Shqyrtimi i mendimit ligjor të të dërguarve zyrtar për KOMRA-n, i cili do t’iu dërgohet kryetarëve të shteteve të rajonit.

kampet dhe të burgosurit, të cilët i janë ekspozuar torturës dhe ekzekutimit pa gjyq. Koordinimi rajonal (rrjeti i organizatave partnere) funksionon në mënyrë të pashembullt, me një përkushtim të madh, me dije dhe me përgjegjësi. Shumica e anëtarëve të Koalicionit përfshihen në debatet për pajtimin, kurse anëtarët e rinj edhe në aksionet në rrugë dhe në fushatat online. Të gjithë anëtarët e Koalicionit e marrin Nismën për KOMRA, që me kohë është bërë një magazinë, e cila shqyrton çështjet aktuale të drejtësisë tranzicionale në vendet post-jugosllave. Takimet me bashkësitë fetare kanë dëshmuar se ekzistojnë vështirësi të mëdha në krijimin e komunikimit dhe në bashkëpunimin me Kishën Ortodokse Serbe në Serbi.

## 1. Aktivitetet

Aktivitetet kanë pasur për qëllim përforsimin e përkrahjes publike për Nismën në themelimin e KOMRA-s, përfshirjen e bashkësisë akademike dhe të artistëve në debat mbi instrumentet e drejtësisë tranzicionale dhe pajtimin në vendet post-jugosllave, fuqizimin e kapaciteteve të organizatave kohët e fundit të themeluara në B dhe H –DTPKBH dhe QDDT – dhe bartjen e Nismës për KOMRA nga niveli civil në nivelin politik.

Të gjitha qëllimet janë përmbushur: aksionet publike kanë treguar se qytetarët nga vendet post-jugosllave e përkrahin Nismën për KOMRA, para së gjithash sepse ajo është për nga karakteri i saj rajonal, me detyra shumë konkrete, dhe ngaqë ka dalë nga niveli lokal; DTPKBH dhe QDDT me sukses e kanë filluar projektin *Vënia në hartë e kampeve në B dhe H*, që drejtpërdrejt i kontribuon përmbushjes së detyrës së KOMRA-s që të regjistrojë të gjitha kampet në luftërat në periudhën kohore 1991-2001; komuniteti i artistëve është bërë promotor i vlerave të bashkëndjesisë si parakusht i afrimit, i respektimit, i besimit dhe i pajtimit në Ballkan; avokuesit publik të Nismës për KOMRA me sukses e kanë filluar transferimin e Nismës për KOMRA në nivel politik – kryetarët e Kroacisë, Serbisë, Kosovës, Malit të Zi, Maqedonisë dhe 2 anëtarë të Presidencës së B dhe H kanë emëruar të dërguarit e tyre personal për KOMRA-n, të cilët e përbëjnë Grupin zyrtar të Ekspertëve Rajonal për KOMRA-n.

### 1.1 Prezantimi i Koalicionit në Internet dhe botimi i *!Nisma për KOMRA*

Prezantimet me anë të Internetit të Nismës për KOMRA janë të një cilësie të lartë informuese dhe grafike. Koalicioni, përkatësisht Nisma për KOMRA i ka profilet e saj në Facebook dhe në Twitter. Faqja e internetit ([www.zarekom.org](http://www.zarekom.org) / [www.perkomra.org](http://www.perkomra.org)) përmban një regjistër të hollësishëm mbi zhvillimin e Nismës për KOMRA. Në periudhën raportuese, në Facebook janë vendosur pothuajse 200 shpallje dhe 22 foto albume nga aksione dhe takime të ndryshme<sup>3</sup>. Në faqen e internetit<sup>4</sup> janë vendosur rreth 250 lajme, komunikata dhe artikuj gazetaresk mbi KOMRA-n në tetë gjuhë (në gjuhën serbe, kroate, boshnjake, malaziasë, shqipe, sllovene, maqedonase dhe angleze). Faqen e internetit, deri në fund të muajit janar të vitit 2014 e kanë vizituar 23,407 shfrytëzues të rrjeteve shoqërore, kurse është shikuar 100,315 herë<sup>5</sup>. Koalicioni për KOMRA ka vazhduar me mbledhjen e nënshkrimeve të përkrahjes dhe të zgjerimit të Koalicionit për KOMRA. Nëpërmjet të faqes së internetit [zarekom.org](http://www.zarekom.org), Koalicionit i janë

<sup>3</sup> <https://www.facebook.com/ZaREKOM.PerKOMRA.ForRECOM>

<sup>4</sup> <http://www.zarekom.org>

<sup>5</sup> Të dhënat janë marrë nëpërmjet të Google Analytics.

qasur 70 anëtarë të ri, derisa 95 individë dhe organizata e kanë nënshkruar peticionin për themelimin e KOMRA-s.

Koalicioni për KOMRA e ka shfrytëzuar fushatën online për të lajmëruar, por edhe si përkrahje për aksionet publike. Fushata online “KOMRA për të ardhmen” ka zgjatur nga data 25 gusht deri në datën 22 shtator të vitit 2012. Gjatë fushatës, qytetarët kanë vendosur në Facebook mesazhet dhe fotografitë e tyre<sup>6</sup>, si dhe mesazhet, duke iu bërë thirrje politikanëve që të sjellin vendimin mbi themelimin e KOMRA-s. Rreth 100 njerëz kanë vënë mesazhe të përkrahjes për themelimin e KOMRA-s, midis të cilëve edhe si më poshtë: *Le të mos përsëritet, Që të mund të dëgjojmë njëri-tjetrin, Është koha për një hap të ri – për KOMRA-n*” dhe ngjashëm. Fushatën, krahas përkrahjes së organizatave partnere në projekt, e ka udhëhequr agjencia *Dokukino*, anëtare e Koalicionit për KOMRA. Fushata *McCann Erickson* nga Mali i Zi *pro bono* ka sjuar video albumin *KOMRA për të ardhmen*<sup>7</sup>, me mesazhe dhe fotografi të aktorëve të njohur. Në Facebook, në mënyrë të rregullt bëhen „evente“, të cilat i paralajmërojnë aktivitetet e Koalicionit, kurse thirrja iu drejtohet mbi 3,500 profileve të shfrytëzuesve të Facebook-ut.

!Zëri i Nismës për KOMRA-n<sup>8</sup>, gazetë e Koalicionit për KOMRA, i informon anëtarët e Koalicionit, shoqërinë civile në vendet post-jugosllave, organizatat ndërkombëtare të cilat merren me drejtësinë tranzicionale, institucionet ndërshtetërore dhe opinionin e gjerë mbi KOMRA-n si dhe mbi instrumentet e tjera të drejtësisë tranzicionale në rajon dhe në botë. Numri i parë i !Zërit ka dalë në muajin dhjetor të vitit 2011 dhe deri në fund të muajit janar të vitit 2014 në pesë gjuhë<sup>9</sup> janë botuar 17 numra (7 botime online dhe 10 të shtypura).

Në periudhën e raportimit janë botuar 11 numra të !Zërit, gjashtë në versionin e shtypur dhe pesë në atë elektronik. Versioni elektronik i !Zërit dërgohet në mijëra adresa (organizatave dhe hulumtuesve të drejtësisë tranzicionale, ambasadave, institucioneve donatore dhe organeve të Bashkimit Evropian). Versioni i shtypur distribuohet anë e kënd rajonit, para së gjithash anëtarëve të Koalicionit për KOMRA, hulumtuesve të drejtësisë tranzicionale dhe institucioneve shtetërore.

## **1.2. Shënimi i Ditës Ndërkombëtare të Personave të Zhdukur<sup>10</sup>**

Qendra qytetare vojvodinase (QQV), në datën 30 gusht të vitit 2012, me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Personave të Zhdukur, ka organizuar në Novi Sad tribunën *Përgjegjësia (NUK) zhduket*. Mbi potencialin e KOMRA-s për t’i kontribuar ndriçimit të fatit të personave të zhdukur kanë folur avokuesit publik të Nismës për KOMRA, Dinko Gruhonjqi, Zheljko Stanetiçi dhe Jovan Kolariçi (QQV), kurse mbi

<sup>6</sup> Fotografitë në faqen e Facebook-ut të Nismës për KOMRA:

<https://www.facebook.com/ZaREKOM.PerKOMRA.ForREKOM?ref=hl>

<sup>7</sup> <http://www.zarekom.org/vesti/REKOM-za-buducnost-mladih-i2557.sr.html>

<sup>8</sup> <http://www.zarekom.org/Glas-Inicijative-za-REKOM/index.sr.html>

<sup>9</sup> Botimi në gjuhën BKSM (në gjuhën boshnjake/serbe/kroate/malaziase) si dhe botimi në gjuhën shqipe, angleze maqedonase dhe sllovene.

<sup>10</sup> <http://www.zarekom.org/vesti/Tribina-Vojvodjanskog-gradjanskog-centra-povodom-Dana-nestalih.sr.html>

problemet e familjeve të personave të zhdukur ka folur Nada Bodiropa, anëtare e Koalicionit për KOMRA (Shoqata e familjeve të personave të vrarë dhe të zhdukur serb në Kroaci).

### **1. 3. KOMRA për të ardhmen<sup>11</sup>**

*KOMRA për të ardhmen*, aksioni i dërgimit të kartolinave kryetarëve të shteteve të rajonit, është mbajtur në datën 22 shtator të vitit 2012 në Zagreb, Prishtinë, Beograd, Sarajevë, Podgoricë, Lubjanë dhe Shkup. Qytetarët, në mënyrë shumë të interesuar, iu kanë shkruar kryetarëve të shteteve mesazhe personale. Të gjithë e kanë lavdëruar idenë që t'iu shkruhet të gjithë kryetarëve të shteteve të rajonit. Secilit kryetar i janë dërguar nga 100 kartolina me mesazhe personale të qytetarëve dhe me thirrjet që të bëjnë hapa konkret dhe vendime si dhe që ta përkrahin KOMRA-n.

#### **1.4. Ballafaqimi me të ardhmen – Përse është koha për KOMRA-n**

Qendra për arsimim qytetar (QAQ), në Podgoricë, në datën 18 tetor të vitit 2012, ka organizuar tribunën mbi ballafaqimin me të ardhmen në kontekst të çështjes *Përse është koha për KOMRA-n*. Në debat kanë marrë pjesë 30 aktivistë të organizatave të shoqërisë civile. Në panel kanë folur juristja Tea Gorjanc Preleviq dhe avokuesit publik të Nismës për KOMRA prof. dr Zharko Puhovski dhe Dragoljub Dushko Vukoviq, avokues, kurse në mënyrë aktive ka marrë pjesë edhe ambasadori i B dhe H në Mal të Zi.

### **1. 5. KOMRA për të ardhmen e të rinjve<sup>12</sup>**

Aksioni *KOMRA për të ardhmen e të rinjve* është mbajtur në datën 24 tetor të vitit 2012, në të njëjtën kohë në Banja Llukë, Sarajevë, Prishtinë, Zagreb, Beograd, Lubjanë, Podgoricë dhe Shkup. Gjatë aksionit, 1,421 qytetarë e kanë nënshkruar peticionin për themelimin e KOMRA-s, kurse 57 individë janë bërë anëtarë të Koalicionit për KOMRA.<sup>13</sup> Aktivistët e Koalicionit për KOMRA ua kanë shpërndarë qytetarëve fletushkën *KOMRA për të ardhmen*, në të cilën, në mënyrë të përmbledhur, është prezantuar zhvillimi i Nismës për KOMRA, si dhe numri i fundit të IZërit të Nismës për KOMRA.

Nën titullin *KOMRA për të ardhmen e të rinjve*, Nisma e të rinjve për të drejtat e njeriut në Serbi (YIHR në Serbi) ka organizuar tribuna dhe aksione të mbledhjes së nënshkrimeve në gjashtë qytete në Serbi: në Novi Sad në datën 12 nëntor të vitit 2012, në Kragujevc në datën 14 nëntor të vitit 2012, në Zrenjanin në datën 19 nëntor të vitit 2012, në Pirot në datën 20 nëntor të vitit 2012, në Suboticë në datën 22 nëntor të vitit 2012 dhe në Nish në datën 23 nëntor të vitit 2012. Në tribuna, mbi procesin KOMRA kanë folur anëtarët e Koalicionit. Qëllimi ka qenë që Nisma për KOMRA t'i afrohet të rinjve në qytete më të vogla si dhe që t'iu ofrohet mundësia qytetarëve jashtë kryeqyteteve që personalisht ta përkrahin Nismën për KOMRA dhe të njihen më shumë me rrjedhën e vet procesit.

<sup>11</sup> <http://www.zarekom.org/vesti/REKOM-za-buducnost-mladih-i2557.sr.html>

<sup>12</sup> <http://www.zarekom.org/vesti/57-novih-clanova-Koalicije-za-REKOM.sr.html>

<sup>13</sup> <http://www.zarekom.org/vesti/57-novih-clanova-Koalicije-za-REKOM.sr.html>

## 1.6. Aksionet e përkujtimit<sup>14</sup>

Me rastin e ditës së të Gjithë të Shenjtëve, Nisma e të rinjve për të drejtat e njeriut në Kroaci (YIHR në Kroaci) ka organizuar në datën 1 nëntor të vitit 2012 aksionin e përkujtimit të viktimave në Sheshin dr. Franjo Tugjman në Zagreb. Shkrimi i emrave të të zhdukurve në një kordele dhe vendosja e tyre në drurë në park e kanë pasur për qëllim që t'i përkujtojnë të rënët në luftën në Kroaci në vitet 1991 - 1995, si dhe rëndësinë e themelimit të KOMRA-s me qëllim të emërimit të të gjitha viktimave, të cilat e kanë humbur jetën. Vendosja e tillë ka qëndruar më shumë se një muaj, duke e nxitur vëmendjen e qytetarëve, kurse vëmendja e mediave ka munguar.

## 1.7. Debati mbi pajtimin në Maqedoni

Qendra për hulumtimin dhe krijimin e politikave (QHKPM) dhe avokuesja publike, prof. dr Biljana Vankovska kanë organizuar në Shkup, në datën 30 nëntor të vitit 2012, tribunën *KOMRA dhe procesi i pajtimit në Maqedoni*. Në takim, i cili i ka tubuar 65 intelektual dhe anëtarë të Koalicionit për KOMRA, kanë folur avokuesit publik të Nismës për KOMRA, prof. dr Biljana Vankovska, Natasha Kandiçi dhe prof. dr Zdravko Grebo, profesori Dimitar Mirçevi nga Universiteti i Shkupit si dhe Suad Misini, anëtar i Koalicionit për KOMRA. Konkluzë kryesore ka qenë se në Maqedoni ekziston nevoja për debat mbi atë se çfarë ka ndodhur në të kaluarën.

## 1.8. Debati mbi pajtimin dhe drejtësinë i vështuar nga këndi i komunitetit akademik dhe artistik<sup>15</sup>

Fondi për të Drejtën Humanitare (FDH), YIHR në Kroaci dhe Shoqata „Drejtësia tranzicionale, përgjegjësia dhe kujtimi në B dhe H“ (DTPK BH) kanë organizuar debate mbi pajtimin nga këndi i vështimit të komunitetit akademik dhe artistik.

Në Sarajevë, debatin e ka organizuar në datën 7 dhjetor të vitit 2012 DTPKBeH, kurse në Beograd, në datën 13 dhjetor të vitit 2012, FDH. Në Zagreb, në datën 28 shkurt të vitit 2013, debatin e kanë organizuar organizatorët e festivalit të filmit dokumentar *ZagrebDox*.

Diskutimi në mënyrë të posaçme është zhvilluar midis artistëve të cilët kanë debatuar se në çfarë mënyrash mund t'ua afrojnë qytetarëve, me krijimtarinë e tyre, temat dhe problemet e drejtësisë tranzicionale. Në debate është kristalizuar qëndrimi i artistëve se bashkë ndjesia është parakusht i afrimit të të vërtetave të ndryshme, të vizioneve, kujtimeve dhe pajtimit me të kaluarën si dhe të heqjes dorë nga shikimi i të tjerëve si armiq.

<sup>14</sup> <http://www.zarekom.org/vesti/Koalicija-za-REKOM-prisjetila-se-zrtava-rat-u-Hrvatskoj.sr.html>

<sup>15</sup> <http://www.zarekom.org/vesti/Debata-o-pomirenju-u-organizaciji-Koalicije-za-REKOM.sr.html>

## **1. 9. Filmi dokumentar mbi fushatën e mbledhjes së nënshkrimeve për themelimin e KOMRA-s<sup>16</sup>**

YIHR në Serbi e ka prodhuar filmin dokumentar mbi fushatën e mbledhjes së nënshkrimeve të përkrahjes për themelimin e KOMRA-s në muajin prill dhe maj të vitit 2011, kur janë mbledhur 543,000 nënshkrime. Filmi është vendosur në faqe të internetit të Nismës për KOMRA.

### **1.10. Shikimi në të djeshmen – hap nga e nesërmja<sup>17</sup>**

Qendra qytetare vojvodinase (QQV) i ka realizuar nëntë emisione nën titullin "Shikimi në të djeshmen – hap nga e ardhmja", të cilat Radio Novi Sadi i ka emituar nga muaji janar deri në muajin mars të vitit 2013. Në emisione është prezantuar Nisma për themelimin e KOMRA-s. Mbi te dhe mbi instrumentet e tjera të ballafaqimit me të kaluarën kanë folur para së gjithash të rinjtë nga rajoni, por edhe hulumtuesit, profesorët dhe praktikistët e drejtësisë tranzicionale.

### **1.11. Raport mbi drejtësinë tranzicionale në vendet post-jugosllave**

FDH, në bashkëpunim me shoqatat DTPK B dhe H, QDDT B dhe H, YIHR në Kroaci, QHKP nga Maqedonia, Civic Link nga Sllovenia dhe Fondin për të Drejtën Humanitare Kosovë (FDH Kosovë), ka zhvilluar hulumtimin mbi gjendjen e drejtësisë tranzicionale në vendet post-jugosllave, mbi hulumtimin e përparimit të reformave institucionale, të drejtësisë penale, reparacionet dhe nismat për tregimin e së vërtetës. Rezultatet e hulumtimit janë publikuar në raportin *Drejtësia tranzicionale në vendet post-jugosllave – raport për vitet 2010/2011*.<sup>18</sup>

Raporti është prezantuar në konferenca për shtyp në të gjitha shtetet e ish-Jugosllavisë, në të cilat kanë marrë pjesë përfaqësuesit e organizatave partnere dhe avokuesit publik.

Prezantimi i parë është mbajtur në Prishtinë në datën 22 mars të vitit 2013 dhe në te, mbi gjendjen e drejtësisë tranzicionale dhe procesin KOMRA kanë folur avokuesit e Nismës për KOMRA Natasha Kandiq dhe Adriatik Kelmendi, drejtori i *Dokufestit* Veton Nurkollari dhe drejtori i FDH Kosovë Bekim Blakaj, kurse Gëzim Kasapolli, zëvendësministër për integritet evropian i Republikës së Kosovës dhe Dhurata Hoxha, kryetare e grupit punues ndërmënisht për ballafaqimin me të kaluarën dhe pajtimin kanë folur mbi punën e këtij grupi punues.

Në Banja Llukë<sup>19</sup>, në konferencën për shtyp të datës 2 prill të vitit 2013, gjetjet kryesore të raportit i kanë prezantuar avokuesit publik të Nismës për KOMRA-s, prof. dr Zharko Puhovski dhe Igor Mekina,

---

<sup>16</sup> <http://www.zarekom.org/Kampanja-prikupljanja-potpisa.sr.html>

<sup>17</sup> <http://www.zarekom.org/radio/index.sr.html>

<sup>18</sup> „Drejtësia tranzicionale në vendet post-jugosllave– raporti për vitet 2010/2011 “ është në dispozicion në <http://www.zarekom.org/vesti/Tranziciona-pravda-u-post-jugoslovenskim-zemljama-izvestaj-za-2010/2011-i2470.sr.html>

<sup>19</sup> <http://www.zarekom.org/vesti/U-Banjaluci-odrzana-javna-debata-o-tranzicionoj-pravdi.sr.html>

kurse mbi gjendjen në B dhe H ka folur profesori Miodrag Zhivanoviqi, anëtar i Këshillit Drejtues i QDDT-së.

Prezantimi i raporteve është mbajtur në Zagreb<sup>20</sup> në datën 8 prill të vitit 2013, kurse kanë folur Natasha Kandiq, prof. dr Zharko Puhovski, Sven Milekiqi avokues lokal i YIHR në Kroaci, Vesna Tersheliqi, drejtoreshë e „Documenta“ dhe Mario Mazhiqi, drejtor i YIHR në Kroaci.

Prezantimi në Beograd<sup>21</sup> është mbajtur në datën 9 prill të vitit 2013. Kanë folur Natasha Kandiq, Denisa Kostovicova, ligjëruese e lartë në Shkollën londineze për ekonomi dhe shkenca politike - LSE, Sandra Orloviqi, drejtoreshë e FDH dhe Mario Mazhiq.

Në Podgoricë<sup>22</sup> raporti është prezantuar në datën 10 prill të vitit 2013, kurse mbi gjendjen e drejtësisë tranzicionale në Mal të Zi kanë folur prof. dr Zharko Puhovski, Natasha Kandiq, Mirela Rebronja, avokuese lokale, QAQ, dhe Daliborka Uljareviqi, drejtoreshë e QAQ.

Profesori Zhidas Daskalovski, drejtor i QHKPM, Biljana Vankovska, avokuese publike e Nismës për KOMRA, Bekim Blakaj, drejtor i FDH Kosovë, dhe Oliver Stanoeski, avokues lokal, e kanë prezantuar raportin në Shkup<sup>23</sup> në datën 12 prill të vitit 2013.

Në Lubjanë<sup>24</sup>, në datën 19 prill të vitit 2013 mbi raportin kanë folur, krahas Igor Mekinës, edhe dr Spomenka Hribar, (publiciste), Matjazh Hanzhek, (ish ombudsperson i Sllovenisë), dr Sergej Flere, (profesor i Fakultetit Filozofik në Maribor dhe drejtor i Qendrës për hulumtim të shteteve post-jugosllave) dhe eurodeputeti nga Sllovenia Jelko Kacin (raportues i PE-së për vendet e Ballkanit Perëndimor).

Prezantimi i fundit është mbajtur në Sarajevë, në datën 15 maj të vitit 2013, dhe në te kanë folur Natasha Kandiq, Dino Mustafiq (regjisor i teatrit dhe avokues publik i Nismës për KOMRA) dhe Midhat Izmirlija (kryetar i SH DTPK BeH).

Organizatrat partnere ua kanë shpërndarë Raportin mbi drejtësinë tranzicionale anëtarëve të Koalicionit për KOMRA, organizatave të shoqërisë civile, institucioneve shtetërore, bibliotekave, institucioneve të BE-së, ambasadave, institucioneve arsimore, hulumtuesve, anëtarëve të bashkësisë epistemologjike dhe individëve të interesuar me kërkesën e tyre (rreth 1,000 kopje).

---

<sup>20</sup> <http://www.zarekom.org/vesti/Predstavljen-regionalni-izvestaj-o-tranzicijskoj-pravdi-u-periodu-2010/2011-godine-u-Zagrebu.sr.html>

<sup>21</sup> <http://www.zarekom.org/vesti/Predstavljeni-Izvestaj-o-tranzicionoj-pravdi-i-casopis-Forum-za-tranzicionu-pravdu.sr.html>

<sup>22</sup> <http://www.zarekom.org/press/Nalogodavci-su-i-dalje-zasticeni.sr.html>

<sup>23</sup> <http://www.zarekom.org/press/Tribina-na-REKOM-go-prezentirase-Izvestajot-za-tranziciona-pravda-vo-post-jugoslovenskite-zemji.mk.html>

<sup>24</sup> <http://www.zarekom.org/vesti/Predstavljen-Izvestaj-o-tranzicionoj-pravdi-u-Ljubljani.sr.html>



### 1.12. Koalicioni për KOMRA-n iu ndihmon »personave të fshirë«<sup>25</sup>

Koalicioni për KOMRA-n në mënyrë aktive iu ka ofruar përkrahje "personave të fshirë" si banorë të Sllovenisë në realizimin e të drejtave në lidhje me kthimin e të drejtave të marra. Anëtarët e Koalicionit për KOMRA-n nga Sllovenia, Civic Link, Nisma e banorëve të fshirë të Sllovenisë (CIIA) dhe Asociacioni i personave të fshirë (ZIS), kanë qenë posaçërisht aktiv në informimin e „personave të fshirë“ që të mos e humbin afatin për të filluar procedurën para institucioneve sllovene. Sipas të dhënave të MPB-së sllovene, Sllovenia në mënyrë të paligjshme ka „fshirë“ 25,671 qytetarë me prejardhje nga republikat e tjera të ish RSFJ-së. Deri në fund të vitit 2013, të drejtat e veta, ia kanë dalë t'i kthejnë (ose e pakta të kërkoj kthimin e të drejtave të hequra) rreth 8,000 »persona të fshirë«. Kjo do të thotë se mbi 18,000 »persona të fshirë« ende nuk e kanë realizuar të drejtën e tyre për kompensim dhe për kthim.

Mbi gjithë këtë si dhe mbi nevojën që krahas kompensimit të viktimave të »personave të fshirë« të vërtetohet edhe konteksti i shkeljes së të drejtave të njeriut, dhe atë përmes KOMRA-s, kanë biseduar panelistët e shumtë në konferenca, të cilat, në organizim të Civic Link-ut dhe anëtarëve të tjerë të Koalicionit për KOMRA-n, janë mbajtur në Lubjanë (19 prill dhe 28 qershor të vitit 2013), Beograd (9korrik të vitit 2013)<sup>26</sup> dhe Sarajevë (17 korrik të vitit 2013)<sup>27</sup>.

Pjesëmarrësit e konferencave në Lubjanë kanë parashtruar vërejtje serioze lidhur me propozimin qeveritar mbi kompensimet. Ata kanë tërhequr vërejtjen në lidhje me shumën e vogël të »kompensimeve jomateriale« - gjithsejtë 40 euro mujore. "Personave të fshirë" iu është shkelur një vëllim më i madh i të drejtave se sa personave të paraburgosur pa bazë. Nuk kanë pasur as sigurim shëndetësor e as pensional, as të drejtën në punë dhe as shumë të drejta të tjera, kurse në të njëjtën kohë nuk kanë pasur as të drejtën në lëvizjen e lirë, me çka është dëmtuar edhe e drejta e tyre në jetën familjare", ka tërhequr vërejtjen dr Sergej Flere, profesor i Universitetit në Maribor dhe anëtar i Koalicionit për KOMRA-n.

Igor Mekina, avokues publik i Nismës për KOMRA dhe drejtor ekzekutiv i Civic link-ut, në konferencën në Beograd e ka tërhequr vërejtjen lidhur me informacionet e paplota në prezantimet në internet të ambasadave sllovene në të gjitha shtetet e rajonit, gjë që tregon se qeveria sllovene edhe më tutje i shmanget përbushjes së obligimeve ndaj „qytetarëve të fshirë“ në lidhje me rregullimin e statutit të tij.

<sup>25</sup> <http://www.zarekom.org/vesti/Koalicija-za-REKOM-pomaze-izbrisanima.sr.html>

<sup>26</sup> <http://www.zarekom.org/vesti/Izbrisanima-konacno-vracaju-prava.sr.html>

<sup>27</sup> <http://www.zarekom.org/vesti/Konferencija-u-Sarajevu-Izbrisanii-uslovi-za-ispravljanie-nepravdi-i-isplatu-odsteta-od-drzave-Slovenije.sr.html>



Aleksandar Todoroviqi, themelues i CIIA, në konferencën në Sarajevë ka përshkruar se si institucionet shtetërore kanë vepruar ndaj banorëve, të cilët nuk kanë qenë sloven: »Kjo ka ndodhur në atë mënyrë që ua 'shpojnë' [dhe ashtu i shkatërrojnë, prishin] të gjitha dokumentet e, pastaj ju më nuk ekzistoni dhe mund t'iu nxjerrin nga shteti.«

### **1.13. Vrapoj për KOMRA-n<sup>28</sup>**

Në muajin korrik të vitit 2013 është filluar me përgatitjet për pjesëmarrje në gjysmë-maratona në B dhe H dhe në Kroaci dhe në maratona në Mal të Zi e në Slloveni me shtypjen e trikovë, të shenjave në formë rrethore të silikonit dhe me slogane me nënshkrimin “Vrapoj për KOMRA-n” si dhe me broshura mbi procesin KOMRA në gjuhët e BKSM dhe atë sllovene.

DTPK BH në fillim të shtatorit ka organizuar dy aksione të rrugës (në datën 7 dhe 14 shtator të vitit 2013), duke iu bërë thirrje qytetarëve që në datën 15 shtator të vitit 2013 në Sarajevë të marrin pjesë në vrapimin *Vrapoj për KOMRA-n*, në kuadër të *Vrapimit të kënaqësisë* në pesë kilometra. Në vrapimin *Vrapoj për KOMRA-n*<sup>29</sup> kanë marrë pjesë 15 aktivistë të Koalicionit për KOMRA nga Serbia dhe rreth 150 pjesëmarrës nga B dhe H. Trikot me nënshkrimin „KOMRA“ i kanë mbajtur rreth 170 pjesëmarrës në gjysmë-maratonën në Sarajevë. Erol Mujanoviqi, drejtor i maratonës sarajevase ka vlerësuar se manifestimi është zhvilluar në shenjë të përkrahjes të Nismës për KOMRA.

Aksioni *Vrapoj për KOMRA-n* është prezantuar në datën 21 dhe 28 shtator të vitit 2013 në Sheshin e Bane Josip Jelaçiqit në Zagreb. Në vrapimin e qytetarëve, në kuadër të manifestimit “Maratona zagrebase” e datës 13 tetor të vitit 2013, rreth 100 pjesëmarrës kanë mbajtur trikot me mbishkrimin *Vrapoj për KOMRA-n*<sup>30</sup>.

Në Lubjanë dhe në Podgoricë, aksioni „Vrapoj për KOMRA-n“ është zhvilluar në kuadër të maratonave lokale, në datën 27 tetor të vitit 2013. Në Podgoricë, pjesëmarrësit e shkollave të mesme kanë vrapuar duke i mbajtur veshur trikot me mbishkrimin *Vrapoj për KOMRA-n*.

### **1.14. E përkrah KOMRA-n**

Me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Paqes, Koalicioni për KOMRA, në datën 21 shtator të vitit 2013 ka organizuar aksionin e rrugës „E përkrah KOMRA-n“ në Banja Llukë, Sarajevë, Beograd, Lubjanë, Podgoricë, Prishtinë, Zagreb dhe Shkup<sup>31</sup>. Aktivistët e Koalicionit për KOMRA i kanë shpërndarë mbi 3,000 fletushka *E përkrah KOMRA-n*<sup>32</sup> dhe i kanë mbledhur 783 nënshkrime të qytetarëve<sup>33</sup> për themelimin e KOMRA-s. Ky ka qenë një rast që aktivistët e Koalicionit për KOMRA-n t'i informojnë qytetarët se është mbajtur takimi i parë i kryetarëve të shteteve të rajonit për KOMRA-n (6 shtator i vitit

<sup>28</sup> <http://www.zarekom.org/Trcim-za-REKOM/index.sr.html>

<sup>29</sup> [http://www.zarekom.org/gallery/Trcim-za-Rekom-Sarajevo-15\\_09\\_2013\\_.sr.html](http://www.zarekom.org/gallery/Trcim-za-Rekom-Sarajevo-15_09_2013_.sr.html)

<sup>30</sup> <https://www.facebook.com/media/set/?set=a.597940660269986.1073741833.575721612491891&type=3>

<sup>31</sup> Fotografitë: <http://www.zarekom.org/gallery/index.sr.html>

<sup>32</sup> <http://www.zarekom.org/documents/Liflet-Podrzavam-REKOM.sr.html>

<sup>33</sup> Më së shumti nënshkrime janë mbledhur në Banja Llukë (RS B dhe H) – 272.

2013), se të gjithë i kanë përkrahur nenet 3 dhe 14 të Statutit të KOMRA-s mbi qëllimet dhe detyrat, por se anëtar i tretë i Presidencës i B dhe H (nga Republika Srpska) dhe kryetari i Sllovenisë ende nuk i kanë emëruar të dërguarit e tyre personal.

Në Sarajevë, aksioni është mbajtur në kuadër të Javës së ndërtimit të paqes<sup>34</sup>; në Shkup, një ditë më herët, avokuesja publike, prof. dr Biljana Vankovska dhe i QHKP kanë mbajtur konferenca për gazetarë, në të cilat mbi Nismën për KOMRA kanë folur si për një instrument për ndërtimin e paqes, (më shumë për këtë shih në 2.4. *Konferencë për shtyp në Shkup*), derisa në Podgoricë qytetarët i kanë shkruar mesazhet e paqes dhe të përkrahjes për themelimin e KOMRA-s si instrument për krijimin e paqes.<sup>35</sup>

### **1.15. Takimi i Koalicionit për KOMRA në Maqedoni<sup>36</sup>**

Në Shkup, në datën 19 tetor të vitit 2013, është mbajtur takimi i anëtarëve Koalicionit për KOMRA nga Maqedonia. Qëllimi i takimit ka qenë analiza e aktiviteteve të deriatëhershme të Koalicionit në Maqedoni, si dhe e problemeve, me të cilat ballafaqohet në funksionimin dhe në promovimin e idesë për formimin e KOMRA-s.

Dobësia e përgjithshme e shoqërisë civile (polarizimi mbi bazën etnike dhe politike, vrapimi pas projekteve) përbënë një nga pengesat për veprim më të fuqishëm dhe përkushtim më të madh për realizimin e qëllimit të përbashkët - formimi i KOMRA-s. Brenda Koalicionit më aktivet janë shoqatat e veteranëve dhe të familjeve të viktimave. Koalicioni ka vlerësuar se përkrahja e institucioneve shtetërore ekskluzivisht deklarative dhe, së këndejmi i ka bërë ftesë kryetarit Ivanon që ta vërtetoj përkrahjen e tij për Nismën për KOMRA me pjesëmarrjen më aktive të të dërguarit të emëruar për KOMRA-n në punën e Grupit Rajonal të Ekspertëve për KOMRA-n.

Anëtarët e Koalicionit për KOMRA edhe njëherit e kanë theksuar rolin e mediave në përf forcimin e përkrahjes publike, shoqërore dhe politike për KOMRA-n dhe iu kanë bërë apel mediave që t'i kushtojnë vëmendje viktimave.

### **1.16. Konsultimet informative me përfaqësuesit e bashkësive rom, ashkali dhe egjiptian<sup>37</sup>**

Fondi për të Drejtën Humanitare Kosovë, Integra dhe Qendra për dokumentacion, hulumtime dhe publikim (QDHP) në datën 28 tetor të vitit 2013 në Prizren (Kosovë) kanë organizuar konsultime informative me përfaqësuesit e bashkësive të romëve, ashkalive dhe egjiptianëve mbi procesin KOMRA dhe ballafaqimin me të kaluarën.

<sup>34</sup> <http://www.zarekom.org/press/Dan-mira-u-BiH-Svaka-osoba-trebala-bi-postati-mirotvorac.sr.html>

<sup>35</sup> <http://www.zarekom.org/press/U-Podgorici-obiljezen-Dan-mira.sr.html>

<sup>36</sup> <http://www.zarekom.org/vesti/Sastanak-clanova-Koalicije-za-REKOM-u-Makedoniji.sr.html>

<sup>37</sup> <http://www.zarekom.org/vesti/Ukljucivanje-zajednica-Roma-Askalija-i-Egipcana-u-proces-suocavanja-sa-prosloscu.sr.html>

Në takim kanë marrë pjesë 30 përfaqësues të këtyre bashkësive si dhe anëtarët e shoqatave të familjeve të viktimave 22 *maji* nga Vushtrria, përndryshe anëtare e Koalicionit për KOMRA. Në debat është konstatuar se ka tejet pak burime të shkruara mbi pësimet e romëve, ashkalive dhe egjiptianëve, si dhe se ka probleme në mbledhjen e dëshmive nga të mbijetuarit dhe anëtarët e familjeve të viktimave. Pjesëmarrësit e takimit iu kanë bërë thirrje bashkësive të romëve, ashkalive dhe egjiptianëve që ta themelojnë shoqatën e familjeve të të zhdukurve, kurse anëtareve të Koalicionit për KOMRA që të ndihmojnë në dokumentimin e pësimeve të romëve, ashkalive dhe egjiptianëve.

#### **1.17. Debate mbi ballafaqimin me të kaluarën konfliktuale në Maqedoni**

Në organizim të Fondacionit Konrad Adenauer, Qendrës për hulumtim dhe krijim të politikave dhe Koalicionit për KOMRA, në datën 4 tetor të vitit 2013 në Tetovë<sup>38</sup> dhe në datën 17 tetor të vitit 2013 në Shkup<sup>39</sup> si dhe datën 9 nëntor të vitit 2013 në Prilep<sup>40</sup>, është mbajtur tryeza e rrumbullakët me titullin *Sfidat e ballafaqimit me të kaluarën konfliktuale* në Maqedonisë. Në konferenca, të cilat kanë pasur për qëllim ngritjen e ndërgjegjes publike dhe të përkrahjes së Nismës për KOMRA, kanë marrë pjesë mbi 100 përfaqësues të organizatave joqeveritare, pjesëmarrës të konfliktit të vitit 2001, përfaqësues të shoqatave të viktimave, profesorë, intelektualë, studentë dhe anëtarë të Koalicionit për KOMRA.

Prof. dr Zhidas Daskalovski ka folur mbi multikulturalizmin e shoqërive të ndara. Albert Hani nga Qendra e Trajnimit për menaxhim të konflikteve, përmes shqyrtimit të saj mbi memorializimin e së kaluarës në shoqërinë ndërkulturore, e ka vënë theksin në kulturën dhe politikën e përkujtimit si dhe në fenomenin e glorifikimit të heronjve të luftës në periudhën post-konfliktuale.

Përfaqësuesja e Fondacionit Konrad Adenauer për Maqedoninë dhe Kosovën, Daniela Popovska ka folur mbi nevojën e ballafaqimit me të kaluarën në kontekst të nevojave gjermane.

Avokuesi publik i Nismës për KOMRA në Maqedoni, Oliver Stanoeski, e ka prezantuar historikun e procesit KOMRA me vështrim të veçantë në bartjen e nismës në nivelin civil në nivelin politik dhe ndërshtetëror si dhe në rezultatin unik të bashkëpunimit rajonal të shoqërive civile nga territori i ish-Jugosllavisë.

---

<sup>38</sup> Në konferencë kanë folur: prof. dr Zhidas Daskalovski, prof. dr Biljana Vankovska, avokuese publike, Oliver Stanoeski, avokues vendor dhe Albert Hani nga Qendra për trajnim për menaxhimin e konflikteve.

<http://www.zarekom.org/vesti/Okrugli-sto-lzazovi-suocavanja-s-konfliktnom-prosloscu-u-Republici-Makedoniji.sr.html>

<sup>39</sup> <http://www.zarekom.org/vesti/Okrugli-sto-lzazovi-suocavanja-s-konfliktnom-prosloscu-u-Republici-Makedoniji-i2636.sr.html>

<sup>40</sup> <http://www.zarekom.org/vesti/Okrugli-sto-u-Plepu-lzazovi-suocavanja-s-prosloscu-u-Makedoniji.sr.html>

Avokuesja publike e KOMRA-s, prof. dr Biljana Vankovska ka folur mbi drejtësinë tranzicionale nga aspekti teorik, krahasues dhe kombëtar, posaçërisht duke e vënë në pah se specificiteti i gjendjes në Maqedoni, sipas mendimit të saj, kërkon aktivitete të veçanta.

## **2. Informimi i publikut mbi institucionalizimin e procesit KOMRA**

Me qëllim të promovimit të idesë mbi themelimin e KOMRA-s, avokuesit publik dhe aktivistët e tjerë të Koalicionit gjatë periudhës së raportimit i kanë mbajtur disa konferenca për shtyp.

### **2.1. Konferenca për shtyp në Sarajevë<sup>41</sup>**

Me rastin e aksionit rajonal *KOMRA për të ardhmen*, avokuesit publik, me përkrahjen e artistëve, në organizim të Shoqatave DTPKP B dhe H, kanë organizuar në datën 20 shtator të vitit 2012 në Sarajevë konferencën për shtyp, në të cilën kanë folur prof. Zdravko Grebo, gazetarja Xhenana Karup-Drushko, aktori Ermin Bravo dhe kryetari i SHO (SHB DTPK B dhe H) Midhat Izmirlija.

Prof. Zdravko Grebo e ka vënë në pah se vetëm Nisma për KOMRA e mundëson që në nivel rajonal të vërtetohen faktet mbi krimet e luftës të kryera në hapësirën e ish Jugosllavisë, humbjet njerëzore dhe personat e zhdukur. Ai iu ka bërë ftesë kryetarëve të shteteve në rajon dhe anëtarëve të Presidencës së B dhe H që të ndërmarrin përgjegjësinë për themelimin e KOMRA-s.

Xhenana Karup-Drushko e ka theksuar se vërtetimi i fakteve përfshin edhe faktet mbi rrethanat, në të cilat janë kryer krimet.

Midhat Izmirlija e ka sjellë të dhënë se Koalicioni për KOMRA përbënë më shumë se 1.800 organizata të shoqërisë civile, të cilat merren me segmente të ndryshme të demokracisë dhe të drejtave të njeriut, por të gjithë anëtarët/et janë të mendimit se organ rajonal ka potencial për të kontribuar në pranimin e padrejtësive të shkaktuara viktimave me qëllim të ndërtimit të kulturës së solidaritetit dhe bashkë ndjesisë.

Aktori Ermin Bravo iu ka bërë ftesë qytetarëve që t'i bashkohen aksionit dhe me këtë të tregojnë gatishmërinë që personalisht t'i kontribuojnë të ardhmes më të mirë.

### **2.2. Konferenca për shtyp në Podgoricë**

---

<sup>41</sup> <http://www.zarekom.org/vesti/Okrugli-sto-u-Prilepu-lzazovi-suocavanja-s-prosloscu-u-Makedoniji.sr.html>

Me rastin e aksionit *KOMRA për të ardhmen* QAA në datën 21 shtator të vitit 2012 në Podgoricë e ka organizuar konferencën për shtyp, në të cilën kanë folur avokuesit publik Dragoljub Dushko Vukoviq, avokuesja lokale Mirela Rebronja dhe regjisori Branko Baletiq.

Mirela Rebronja e ka paralajmëruar një fazë të procesit të KOMRA-s, që ka për qëllim që nismën civile ta bartë në nivel politik. Posaçërisht ka vënë në pah përkrahjen e artistëve dhe të kompanive të marketingut për Nismën për KOMRA, gjë që në publik është pritur me miratim të madh.

Regjisori Branko Baletiqi nga perspektiva e tij personale ka folur mbi nevojën e vërtetimit të fakteve mbi gjithë atë që ka ndodhur në të kaluarën për shkak të së ardhmes dhe të gjeneratave të reja.

Leka Dedivanoviq nga agjencioni McCann Erickson ka thënë se agjencia e tij e ka kuptuar rolin shoqëror të Nismës për KOMRA dhe, prej këndej burojnë ato fotografi të mira, të cilat e promovojnë këtë ide.<sup>42</sup>

### **2.3. Konferenca për shtyp në Shkup**

Prof. Biljana Vankovska, avokuese publike e Nismës për KOMRA, konferencën për shtyp, të organizuar në datën 21 shtator të vitit 2012 në Shkup, në Ditën Ndërkombëtare të Paqes, ia ka kushtuar informimit të mediave dhe të publikut lidhur me rëndësinë e KOMRA-s për ballafaqimin me të kaluarën në Maqedoni.

Konferencën e ka hapur drejtori i QKPM prof. Zhidas Daskalovski, i cili ka bërë një prezantim të shkurt të procesit KOMRA.

Prof. Vankovska ka theksuar se konferenca nuk është e caktuar rastësisht në ditën kur në gjithë botën shënohet Dita Ndërkombëtare e Paqes, sepse procesi i pajtimit dhe i ballafaqimit me të kaluarën konfliktuoze përbënë një pjesë të patejkalueshme të procesit paqësor dhe të demokratizimit të çdo shoqërie. Duke folur për institucionalizimin e procesit të KOMRA-s, e Vankovska ka theksuar mbështetjen e kryetarit të Malit të Zi, Filip Vujanoviqit, i cili kolegëve të tij të rajonit iu është drejtuar me letër me nismën që të fillohet me punën konkrete në themelimin e KOMRA-s.

Prof. Siljanovska-Davkova ka vënë në dukje rëndësinë e KOMRA-s për zhvillimin e mëtejshëm të të gjithë rajonit, por edhe të shtetit të Maqedonisë.

---

<sup>42</sup> <http://www.zarekom.org/vesti/REKOM-za-buducnost-mladih-i2557.sr.html>

Avokuesi publik Oliver Stanoeski iu ka bërë ftesë qytetarëve që ta mbështesin aksionin *KOMRA për të ardhmen* me nënshkrimin e kartolinave, të cilat do t'i dërgohen kryetarëve të shteteve të rajonit.

#### **2.4. Konferenca për shtyp në Shkup<sup>43</sup>**

Një vit më vonë, në datën 20 shtator të vitit 2013, prapë në kontekst të Ditës Ndërkombëtare të Paqes, avokuesja publike prof. Biljana Vankovska, në konferencë për shtyp ka folur mbi fillimin e procesit të transferimit të Nismës nga niveli civil në nivelin politik, posaçërisht mbi detyrat e Grupit Rajonal të Ekspertëve për KOMRA-n, që në fillim të shtatorit ka mbajtur takimin e vet të parë. Ajo ka theksuar se kryetari i Maqedonisë Ivanov ka qenë shefi i parë i shtetit, i cili e ka emëruar të dërguarin e tij personal për KOMRA-n.

Në konferencë kanë marrë pjesë edhe anëtarët e Koalicionit, gjenerali Ilija Nikolovski, përfaqësues i Shoqatës së Veteranëve të Forcave të Sigurisë të Maqedonisë, dhe Raim Limani, përfaqësues i Shoqatës së Veteranëve ANA. Ata e kanë theksuar përkrahjen e anëtarësisë së tyre dhe iu kanë bërë ftesë mediave dhe qytetarëve që, pa marrë parasysh përkatësinë etnike, t'i japin përkrahje KOMRA-s.

#### **2.5. Avokuesit publik i kanë bërë ftesë Republika Srpska që të përfshihet në procesin për KOMRA<sup>44</sup>**

Në organizim të QDDT, avokuesit publik të Nismës për KOMRA, prof. Zharko Puhovski, regjisori Dino Mustafiq dhe koordinatori e procesit KOMRA Natasha Kandiç, kanë mbajtur në datën 12 dhjetor të vitit 2013 në Banja Llukë konferencën për shtyp. Avokuesit i kanë bërë thirrje kryetarit të Republika Srpska Milorad Dodikut dhe anëtarit të Presidencës së B dhe H Nebojsa Radmanović që t'i bashkohen kryetarëve të Serbisë, Kroacisë, Malit të Zi, Kosovës, Maqedonisë dhe dy anëtarëve të Presidencës së B dhe H në përkrahjen e tyre formale për nismën civile që të themelohet KOMRA.

Avokuesit kanë informuar mediat se Grupi Rajonal i Ekspertëve për KOMRA-n, të cilin e përbëjnë të dërguarit personal të kryetarëve/presidencës së shteteve të rajonit, i ka mbajtur dy takime dhe se është në interesin e viktimave nga Republika Srpska që në punën e këtij grupi zyrtar të përfshihet edhe përfaqësuesi i anëtarit (serb) të tretë të Presidencës së B dhe H.

#### **2.6. Avokuesit publik të KOMRA-s në ndërtimin e kulturës së bashkë ndjesisë, solidaritetit dhe respektimit të viktimave<sup>45</sup>**

<sup>43</sup> <http://www.zarekom.org/press/REKOM-VREME-E-ZA-INSTITUCIONALIZACIJA-NA-INICIJATIVATA.mk.html>

<sup>44</sup> <http://www.zarekom.org/vesti/Javni-zagovaraci-pozvali-Republiku-Srpsku-da-se-ukljuci-u-proces-REKOM.sr.html>

Në konferencën për gazetarë të mbajtur në Beograd në datën 24 janar të vitit 2014, avokuesit publik të Nismës për KOMRA, profesor Zharko Puhovski, regjisor Dino Mustafiqi, gazetari Adriatik Kelmendi dhe koordinatori e procesit KOMRA, Natasha Kandi, iu kanë bërë ftesë vendeve post-jugosllave për ndërtimin e bashkëndjesisë, solidaritetit dhe respektimit të viktimave të luftës nga hapësira e ish Jugosllavisë<sup>45</sup>.

Profesor Zharko Puhovski ka folur mbi rëndësinë e komunikimit, të cilin avokuesit e kanë realizuar me kryetarët e shteteve dhe e ka nënvizuar se „KOMRA është edhe një hap më afër që të bëhet organ i caktuar ndërshtetëror, parlamentar“.

Natasha Kandi ka informuar gazetarët mbi rrjedhën e bartjes së Nismës për KOMRA nga niveli civil në nivel politik, duke e shprehur kënaqësinë me bashkëpunimin e arritur rajonal në kontekst të ballafaqimit me të kaluarën dhe konkretizimin e përkrahjes politike për themelimin e KOMRA-s, mbi themelimin dhe punën e mirë të Grupit Rajonal të Ekspertëve për KOMRA-n.

Dino Mustafiqi e ka vënë në spikamë bashkë ndjesinë, pa të cilën nuk mund të arrihet respektimi i viktimave, kurse Adriatik Kelmendi me rrëfimin mbi përvojën personale ka vënë në pah nevojën e dokumentimit të vrasjes së të gjitha viktimave<sup>47</sup>.

### 3. Takimet rajonale

#### 3.1. Takimi rajonal i Koalicionit për KOMRA

Takimi rajonal i Koalicionit për KOMRA është mbajtur në datën 8 shtator të vitit 2012 në Beograd dhe në te kanë marrë pjesë 60 anëtarë të Koalicionit. Për herë të parë anëtarët e Koalicionit kanë folur për kujtimet e tyre nga lufta dhe mbi luftën (sesioni *Çka mbajmë në mend, çka na kujtohet*, i botuar në numrin 10 të !Zërit të KOMRA-s)<sup>48</sup>. Në mesin e pjesëmarrësve ka pasur viktimë, të cilat për herë të parë kanë folur mbi përvojat e tyre të luftës, dhe të rinjë të cilët për krimet e luftës kanë mësuar më shumë falë pjesëmarrjes në procesin KOMRA.

#### 3.2. Takimet me bashkësitë fetare

Me qëllim të përforsimit të përkrahjes së bashkësive fetare për Nismën për KOMRA, QHRPSH (Qendra për Hulumtimin e Religjionit, politikës dhe Shoqërisë) ka organizuar tetë takime me përfaqësuesit e lartë të bashkësisë katolike, ortodokse dhe islame si dhe me bashkësitë e vogla fetare.

---

<sup>45</sup> <http://www.zarekom.org/vesti/Javni-zagovaraci-REKOM-a-pozivaju-na-izgradnju-kulture-saosecanja-solidarnosti-i-postovanja-zrtava.sr.html>

<sup>46</sup> <http://www.zarekom.org/press/Izgradimo-kulturu-solidarnosti-i-postovanja.bs.html>

<sup>47</sup> <http://www.zarekom.org/press/Kosovska-sveska-Uspori-pod-porodice-Radevic.sr.html>

<sup>48</sup> <http://www.zarekom.org/Glas-Inicijative-za-REKOM/Glas-Inicijative-za-REKOM-10-2012-BHSC.sr.html>



Përfaqësuesit e Koalicionit për KOMRA janë takuar në datën 27 shkurt të vitit 2013 me metropolitin, shkëlqesinë e tij kryepeshkopin Hoçevarin dhe rabinin beogradas, Isak Asielin, kurse në datën 18 mars të vitit 2013 në Beograd me myftiun serbian Muhamed Jusufspahiqin.

Në Sarajevë, B dhe H, delegacioni<sup>49</sup> i Koalicionit për KOMRA është takuar në datën 16 maj të vitit 2013 me metropolitin, kryepeshkopin kardinalin bosanas Vinko Puljiqin<sup>50</sup>. Në të njëjtën ditë, delegacioni, në të njëjtën përbërje, ka pasur takim edhe me përfaqësuesin e Mitropolisë Dabrobosanase në Sarajevë, atin Vanja, pahor i Kishës së Vjetër Serbe.

Me qëllim të përforcimit të përkrahjes së kishave dhe të bashkësive fetare për Koalicionin për KOMRA, në datën 11 qershor të vitit 2013, delegacioni i KOMRA-s<sup>51</sup> ka vizituar mitropolitin zagrebas-lubjanas, Jovanin në selinë e Mitropolisë zagrebase-lubjanase në Zagreb, pastaj kryepeshkopatën e Zagrebit, Qendrën Islamike dhe myftiun zagrebas efendi Aziz Hasanoviqin<sup>52</sup>.

### **3.3. Forumi IX ndërkombëtar për drejtësinë tranzicionale<sup>53</sup>**

Forum i IX Ndërkombëtar për drejtësinë tranzicionale nën titullin *Pajtimi në vendet post-jugosllave* është mbajtur në datën 17 dhe 18 maj të vitit 2013 në bjeshkën Jahorina, në B dhe H. Në aspektin teknik dhe programor, Forumin e ka përgatitur ekipi i avokuesve vendor nën udhëheqjen e koordinatores së projektit dhe të procesit KOMRA, Natasha Kandiqi. Forumin e kanë përcjellë 220 aktivistë të organizatave të shoqërisë civile, duke përfshirë edhe shoqatat e viktimave, të familjeve të personave të zhdukur dhe të veteranëve, artistë, anëtarë të bashkësisë akademike, përfaqësues të institucioneve shtetërore të B dhe H dhe nga rajoni, të institucioneve ndërkombëtare dhe të bashkësive fetare. Pjesëmarrësit paraprakisht i kanë marrë tekste të panelistëve mbi pajtimin në gjuhën BKSM dhe atë angleze. Forumin e ka hapur Dino Mustafiqi, avokues publik i Nismës për KOMRA, kurse pastaj pjesëmarrësit i ka përshëndetur Zheljko Komshiqi, anëtar i Presidencës së B dhe H.

Në forum është folur për të arriturat në vendosjen e drejtësisë tranzicionale në vendet post-jugosllave, për përvojën e Irlandës Veriore, pajtimin nga këndvështrimi i shteteve, i bashkësive fetare, i bashkësisë shkencore, i bashkësisë artistike dhe kulturologëve, organizatave të shoqërisë civile si dhe mbi trashëgiminë e Tribunalit të Hagës në funksion të pajtimit. Prezantimet dhe diskutimet janë incizuar në mënyrë që organizatorët e Forumit të botojnë transkriptin e debateve dhe të teksteve të përgatitura në mënyrë speciale për Forumin në formë të një përmbledhjeje. Mbi të do të flitet në debatet e

---

<sup>49</sup> Në takim kanë marr pjesë koordinatorja rajonale e Procesit KOMRA Natasha Kandiq, Nikolla Knezheviq (CIRDP), regjisor i teatrit dhe avokues publik Dino Mustafiq, dhe anëtarja e Koalicionit për KOMRA Nuna Zvizdiq (Drejtoreshë e „Gratë Grave“).

<sup>50</sup> <http://www.zarekom.org/vesti/Kardinal-Puljic-je-naglasio-vaznost-prastanja-povjerenja-i-pomirenja-utemeljenog-na-istini.sr.html>

<sup>51</sup> Në takim kanë marr pjesë Natasha Kandiq, Nikolla Knezheviq, Ollivera Jovanoviq (Kisha e Vjetër në Sarajevë, koordinatorja për komunikim me bashkësitë fetare në B e H), Vesna Tersheliq (Documenta) dhe Katarina Kruhonja (anëtare e Koalicionit për KOMRA).

<sup>52</sup> <http://www.zarekom.org/vesti/Inicijativa-za-REKOM-u-poseti-zagrebackim-verskim-zajednicama--izvestaj.sr.html>

<sup>53</sup> <http://www.zarekom.org/vesti/Pomirenje-u-post-jugoslovenskim-zemljama-IX-Medjunarodni-forum-za-tranzicionu-pravdu-izvestaj.sr.html>

planifikuara mbi pajtimin të vështruara nga këndvështrimi i viktimave, në të cilat do të marrin pjesë edhe anëtarët e bashkësisë akademike dhe artistët.

Forumi ka qenë një temë e rëndësishme në mediat e B dhe H dhe në rajon. Mbi Forumin kanë raportuar portali B92 dhe *E novine* nga Serbia, gazetatat ditore *Novi list* nga Kroacia, *Mladina* dhe *Večer* nga Sllovenia si dhe një numër i madh i veb-portaleve nga B dhe H: *radiosarajevo.ba*, *sutra.ba*, *source.ba*, *citaj.ba*, *frontal.ba*, agjencia e lajmeve „Fena“, Televizioni federal, javorja *Dani*<sup>54</sup>, gazetatat ditore *Oslobođenje* dhe *Nezavisne*, veb-portali rajonal „Balkan investigative reporting network“ (BIRN), portali „Deutsche Welle“, TV 1 i Malit të Zi dhe media të tjera.

Organizatorët e Forumit, 10 ditë pas Forumit, kanë botuar rezymetë e debateve, të cilat janë në dispozicion në veb-faqet e Koalicionit për KOMRA.

### **3.4. Kuvendi i Gjashtë i Koalicionit për KOMRA**

Kuvendi i Gjashtë i Koalicionit për KOMRA është mbajtur në datën 17 maj të vitit 2013, në Jahorinë, B dhe H. Në Kuvend kanë marrë pjesë 80 anëtarë të Koalicionit për KOMRA dhe atë 62 përfaqësues të organizatave joqeveritare dhe 18 individë nga Maqedonia, Bosnja dhe Hercegovina, Serbia, Kroacia, Mali i Zi, Sllovenia dhe nga Kosova.

Kuvendi e ka miratuar raportin mbi aktivitetet e Koalicionit për KOMRA dhe të avokuesve publik, por nuk e ka miratuar *Propozimin e parimeve minimale për përkrahje për KOMRA-n zyrtare. Delegatët kanë përfunduar se* Koalicioni duhet të sjellë një qëndrim mbi parimet minimale pasi që shtetet të japin mendimin e tyre mbi Propozim Statutin e KOMRA-s, të cilin Koalicioni e ka miratuar në datën 26 mars të vitit 2011.

### **3.5. Funksionimi i Këshillit Rajonal të Koalicionit për KOMRA**

Rrjetin e organizatave partnere të tubuara rreth Këshillit Rajonal të Koalicionit për KOMRA e përbëjnë FDH, FDH Kosovë, YIHR në Kroaci, YIHR në Serbi, QTD, DTPOS në B dhe H, QAQ, Civic Link, CRPM i CIRPD. Këshilli Rajonal është organ efikas operativ, i cili me lehtësi arrin marrëveshje dhe në mënyrë precize i realizon aktivitetet për të cilat është arritur marrëveshja. Avokuesit lokal nga organizatat partnere janë të njohur në bashkësitë e tyre si promotor të drejtësisë tranzicionale dhe të Nismës për KOMRA.

Gjatë periudhës raportuese janë tri takime të Këshillit Rajonal: 6 shtator të vitit 2012, 1 qershor dhe 14 dhjetor të vitit 2013. Në takime janë analizuar aktivitetet e zhvilluara si dhe rezultatet e arritura dhe janë bërë plane të reja të veprimit. Janë shqyrtuar aktivitetet e reja në kontekstin e nevojës për fuqizimin e përkrahjes publike dhe të bartjes së Nismës për KOMRA nga niveli civil në atë politik.

---

<sup>54</sup> <http://www.zarekom.org/press/Kako-ukloniti-rusevine-proslosti.sr.html>

### **3.6. Takimet e avokuesve publik të Nismës për KOMRA**

Ekipi Rajonal i Avokuesve Publik (ERAP) është formuar në muajin tetor të vitit 2011, me çka kanë filluar përgatitjet për fazat e reja të procesit KOMRA – bartja nga niveli civil në atë politik. (Më shumë për këtë shih në 4. *Avokimi politik i Nismës për themelimin e KOMRA-s*). Në periudhën prej muajit shtator të vitit 2012 e deri në fund të muajit janar të vitit 2014 avokuesit publik i kanë mbajtur tri takime (7 shtator të vitit 2012, 18 qershor të vitit 2013 dhe 24 janar të vitit 2014).

Duke u nisur nga fakti se Propozim Statuti i KOMRA-s përbënë dokumentin nismëtar në ndërtimin e konsensusit minimal për shqyrtimin në nivel zyrtar, avokuesit publik kanë miratuar strategjinë dhe i kanë përkufizuar qëllimet e evokimit publik. Në takime, avokuesit publik e kanë analizuar situatën politike në vendet post-jugosllave në kontekstin e zgjedhjeve dhe të ndryshimeve të shpeshta politike, të cilat e detyrojnë Koalicionin për KOMRA që gjithnjë prej fillimit të kërkojë përkrahjen politike për themelimin e KOMRA-s.

Vëmendje e veçantë i është kushtuar formimit dhe punës së Grupit Rajonal të Ekspertëve të të dërguarve për KOMRA-n. Në takimin e datës 18 qershor të vitit 2013, avokuesit publik kanë sjellë vendimin që në emër të Koalicionit për KOMRA, në punën e Grupit Rajonal të Ekspertëve të marrin pjesë Midhat Izmirlija, anëtarë i Grupit Punues të Koalicionit për përpunimin e Statutit të KOMRA-s, dhe Natasha Kandiç, avokuese publike dhe koordinatore e procesit KOMRA. Pjesëmarrja e tyre është kufizuar në dhënien e interpretimit autentik të dispozitave të Propozim Statutit të KOMRA-s

### **4. Avokimi Politik i Nismës për themelimin e KOMRA-s**

Me propozimin e organizatave partnere, Ekipin Rajonal të avokuesve publik e përbëjnë: Zdravko Grebo, profesor në Fakultetin e Drejtësisë në Sarajevë, Dino Mustafiqi, regjisor i teatrit, dhe gazetarja Xhenana Karup-Drushko (B dhe H), Zharko Puhovski, profesor në Fakultetin Filozofik në Zagreb (Kroaci), Biljana Vankovska, profesoreshë në Fakultetin Filozofik në Shkup (Maqedoni), gazetari Igor Mekina (Slloveni), gazetari Dragoljub Vuković (Mali i Zi), gazetari Adriatik Kelmendi (Kosovë), gazetari Dinko Gruhonjiq dhe aktivistja për të drejtat e njeriut, Natasha Kandiç (Serbi).

Detyrë e avokuesve publik ka qenë që ata, me anë të autoritetit të tyre personal dhe profesional, ta vënë në lëvizje procesin e institucionalizimit të Nismës për KOMRA. Me qëllim të arritjes së kësaj, avokuesit publik kanë mbajtur takime të shumta me përfaqësuesit e institucioneve vendore shtetërore, posaçërisht në Maqedoni dhe në Slloveni, duke pasur parasysh faktin se procesi konsultativ i KOMRA-s ka filluar më herët në këto shtete se sa në shtetet e tjera.

**Prof. dr Biljana Vankovska** i ka mbajtur tetë takime<sup>55</sup> me përfaqësuesit e institucioneve shtetërore, të partive politike, me ambasadorë dhe me përfaqësues të institucioneve të BE-së në Maqedoni. Me kryetarin e Maqedonisë, George Ivanovin, ajo është takuar në datën 24 tetor të vitit 2012<sup>56</sup>, dhe sërish në datën 30 nëntor të vitit 2012, kur në takim<sup>57</sup> kanë marrë pjesë edhe avokuesit publik, prof. Zdravko Grebo dhe Natasha Kandiç.

**Igor Mekina** ka pasur tetë takime me deputetët e Parlamentit Evropian nga Sllovenia, me përfaqësuesit e institucioneve shtetërore dhe të ambasadave të huaja në Slloveni<sup>58</sup>.

**Adriatik Kelmendi** është takuar me një numër të madh të përfaqësuesve të institucioneve shtetërore dhe të BE-së në Kosovë<sup>59</sup>. Në emisionin jashtëzakonisht të njohur „Rubikon“, të cilin e transmeton

---

<sup>55</sup> Me ministren e punëve të brendshme të Republikës së Maqedonisë, Gordana Jankulovskën është takuar në datën 30 nëntor të vitit 2012, me ministrin për punë të jashtme Nikola Poposki në datën 3 dhjetor të vitit 2012, me përfaqësuesin e komitetit parlamentar për marrëdhënie me bashkësinë ndërkombëtare Ermira Mehmeti-Devaja dhe deputetin Talat Xhaferi nga Bashkimi Demokratik për Integrim në datën 10 dhjetor të vitit 2012, me shefin e Bashkimit Evropian, ambasadorin Aivam Orava në datën 10 dhjetor të vitit 2012, me zëvendëskryeministrin e Qeverisë të angazhuar për çështje evropiane Teuta Arifin në datën 17 dhjetor të vitit 2012.

(<http://www.zarekom.org/vesti/Saopstenje-Arifil-sa-sastanka-sa-javnim-zagovaracem-REKOM-a.sr.html>) dhe me Kryetarin e Kuvendit Trajko Veljanoskin në datën 17 janar të vitit 2013(<http://www.zarekom.org/vesti/Saopstenje-o-susretu-izmedju-Predsednika-Skupstine-Republike-Makedonije-Trajka-Veljanoskog-i-javne-zagovaracice-za-REKOM-u-Republici-Makedoniji-prof-Biljane-Vankovske.sr.html>).

<sup>56</sup> <http://www.zarekom.org/vesti/Predsednik-Republike-Makedonije-prof-dr-Djorge-Ivanov-razgovarao-sa-javnim-zagovaracem-Inicijative-REKOM-prof-dr-Biljanom-Vankovskom.sr.html>

<sup>57</sup> <http://www.zarekom.org/vesti/Predsednik-Ivanov-je-primio-predstavnike-Regionalne-Koalicije-za-REKOM.sr.html>

<sup>58</sup> Ka pasur takim me Jelko Kacinin, deputetin e Parlamentit Evropian dhe Raportuesin e Parlamentit Evropian për vendet e Ballkanit Perëndimor (në datën 23 nëntor të vitit 2012. (<http://www.zarekom.org/vesti/Jelko-Kacin-Pravi-trenutak-za-REKOM.sr.html>), me Ivo Vajgëlin, deputetin e PE (4 dhjetor të vitit 2012), me Tanja Fajonin, deputeten e PE (5 dhjetor të vitit 2012), me Natasha Gorshek Mencin, drejtuesen e Presidencës së Komisionit Evropian në Slloveni (15 dhjetor të vitit 2012), me Zdenko Čebashek Travnikun, mbrojtësen e të drejtave të njeriut në datën 24 dhjetor të vitit 2012. (<http://www.zarekom.org/vesti/Slovenacka-zastitnica-ljudskih-prava-ce-se-licno-angazovati-da-REKOM-bude-osnovan.sr.html>), me Gregor Virantin, kryetarin e Listës Qytetare në datën 7 shkurt të vitit 2013. (<http://www.zarekom.org/vesti/Gregor-Virant-o-REKOM-Humana-inicijativa-koju-sa-radoscju-podrzavam.sr.html>), me Joseph A. Mussomelin, ambasadorin e SHBA-ve në datën 12 shkurt të vitit 2013. (<http://www.zarekom.org/vesti/Joseph-Mussomeli-ambasador-SAD-Kljucna-uloga-Slovenije-u-pomirenju-na-Balkanu.sr.html>) dhe me Borut Pahorin, kryetarin e Sllovenisë në datën 17 shkurt të vitit 2013. (<http://www.zarekom.org/vesti/Predsednik-Slovenije-Borut-Pahor-REKOM-potreban-radi-pomirenja-i-jacanja-poverenja-medju-narodima.sr.html>).

<sup>59</sup> Me Peter Blomeyerin, ambasadorin gjerman në datën 29 nëntor të vitit 2012.

(<http://www.zarekom.org/vesti/Ambasador-Nemacke-na-Kosovu-podrzao-Inicijativu-REKOM.sr.html>)<sup>59</sup> me Krystyn Marty, ambasadorin e Zvicrës në Kosovë në datën 08 shkurt të vitit 2013.

(<http://www.zarekom.org/vesti/Ambasadorka-Krystyna-Marty-podrska-regionalnom-pristupu-u-suocavanju-sa-prosloscu.sr.html>) me Zoran Vodopijën, ambasadorin e Kroacisë në datën 17 shkurt të vitit 2013.

(<http://www.zarekom.org/vesti/Ambasador-Vodopija-Hrvatska-podrzava-REKOM-za-bolje-medjususedske-odnose-u-regionu.sr.html>) Kelmendi ka pasur edhe takime në lidhje me emërimin e të dërguarit personal, dhe atë me këshilltarët personal të presidentes së Kosovës, Atifete Jahjaga - Ramush Tahirin dhe Arbër Vllahiun (18 tetor të vitit 2012), dhe Garentina Krajën e Arber Vllahiun (në datën 14 janar të vitit 2013), me Selim Selimin, të dërguarin personal të presidentes (në datën 8 prill të vitit 2013) dhe Dominic-Haydn Braithwaite, këshilltarin politik rajonal dhe këshilltarin për parandalimin e konflikteve pranë FCO-u (Foreign and Commonwealth Office), në datën 17 prill të vitit 2013.

televizioni privat „Kohavision“, Kelmendi, në datën 8 tetor të vitit 2012 e ka zhvilluar intervistën me presidenten e Kosovës, Atifete Jahjagën, e cila ka pasur të bëjë edhe me Nismën për KOMRA.

**Ekipi i avokuesve publik në B dhe H** ka pasur katër takime<sup>60</sup> me përfaqësuesit e institucioneve të B dhe H, një me delegacionin e BE-së dhe një me ambasadorin e SHBA-ve në B dhe H.

**Prof. dr Zharko Puhovski** ka zhvilluar një komunikim të shpeshtë me kryetarin e Kroacisë dhe me këshilltarët e tij.

**Natasha Kandiç**, për Nismën për KOMRA dhe për institucionalizimin e këtij procesi si dhe për emërimin e të dërguarve personal të kryetarëve të shteteve të rajonit ka biseduar me nënkryetarin e Qeverisë së Serbisë Aleksandar Vuçiqin në datën 22 prill të vitit 2013, i cili e ka premtuar mbështetjen e plotë në qasjen në nivel rajonal në ballafaqimin me të kaluarën.

#### **4.1. Institucionalizimi i Procesit KOMRA**

Angazhimi i avokuesve publik ka rezultuar me formimin e Grupit të Ekspertëve Rajonal për KOMRA-n, të cilin e përbëjnë të dërguarit personal të kryetarëve të shteteve të rajonit, pos që kryetari i Sllovenisë dhe anëtari i Presidencës së B dhe H nga Republika Srpska ende nuk i kanë emëruar të dërguarit e tyre për KOMRA-n. Detyrë e tyre është të analizojnë Propozim Statutin e KOMRA-s dhe që të japin mendimin e tyre juridik mbi dispozitat të cilat e rregullojnë themelimin, mandatin dhe obligimet e shtetit në kontekstin e kushtetutave dhe legjislacioneve kombëtare.

Kryetari Kroacisë, Ivo Josipović e ka emëruar Zlata Gjurgjeviqin, profesoreshë e rregullt e Fakultetit të Drejtësisë të Universitetit të Zagrebit, në datën 25 janar të vitit 2013; kryetari i Maqedonisë, Gjorge Ivanov e ka emëruar Luben Arnaudoskin, zëvendës i sekretarit të përgjithshëm për çështje ligjore dhe organizative në kabinetin e tij, në datën 25 janar të vitit 2013; kryetari i Malit të Zi, Filip Vujanović e ka emëruar dekanin e Fakultetit të Shkencave Politike në Podgoricë, profesoreshën Sonja Tomović-Shundiçin, këshilltare e presidentit në fushën e të drejtave të njeriut dhe të pakicave, në datën 28 janar të vitit 2013<sup>61</sup>; presidentja e Kosovës, Atifete Jahjaga e ka emëruar Selim Selimin, këshilltarin e saj personal, në datën 25 mars të vitit 2013<sup>62</sup>; anëtari i Presidencës së B dhe H, Zheļjko Komshiqi e ka emëruar Goran Mihajloviqin, jurist, oficer për ndërlidhje me Tribunalin e Hagës në datën 25 mars të vitit 2013, kurse anëtari i Presidencës së B dhe H, Bakir Izetbegović e ka emëruar nënkryetarin e Sarajevës, juristin Aljosh Çamparën për të dërguarin e tij personal në datën 21 shkurt të vitit 2013. Kryetari i

---

<sup>60</sup> Me Haris Bashiqin, këshilltarin e anëtarit të Presidencës së B dhe H (në datën 28 janar të vitit 2013), me anëtarin e Presidencës, Bakir Izetbegovićin (21 shkurt të vitit 2013), me Aljosh Çamparën, të dërguarin special të anëtarit të Presidencës së B dhe H, me Bakir Izetbegovićin (në datën 1 mars të vitit 2013) dhe me Zheļjko Komshiqin, anëtarin e Presidencës së B dhe H (në datën 25 mars të vitit 2013).

<sup>61</sup> <http://www.zarekom.org/vesti/Predsednici-Hrvatske-Makedonije-i-Crne-Gore-imenovali-licne-izaslanike-za-REKOM.sr.html>

<sup>62</sup> <http://www.zarekom.org/vesti/Predsednica-Kosova-imenovala-licnog-izaslanika-za-REKOM.sr.html>

Serbisë, Tomislav Nikoliqi e ka emëruar Sinisha Vazhiqin, gjyqtar në Gjykatën e Apelit në Beograd, të dërguar të tij personal në datën 30 qershor të vitit 2013<sup>63</sup>.

Takimi i parë i të dërguarve personal të kryetarëve të shteteve, krahas pjesëmarrjes së avokuesve publik të Nismës për KOMRA dhe anëtarit të Grupit Punues të Koalicionit për KOMRA-n, që e ka përpiluar Propozim Statutin, është mbajtur në datën 6 shtator të vitit 2013 në Zagreb. Në punë kanë marrë pjesë të dërguarit personal të kryetarëve të Kroacisë, Serbisë, Malit të Zi, Kosovës dhe dy anëtarë të Presidencës së B dhe H. Të dërguarit e kryetarëve të shteteve të rajonit dhe avokuesit publik janë pajtuar që Propozim Statuti i KOMRA-s, të cilin e ka miratuar Koalicioni për KOMRA në datën 26 mars të vitit 2011, është dokumenti nismëtar në ndërtimin e konsensusit minimal për debatin në nivel zyrtar. Të dërguarit i kanë dhënë përkrahje të plotë neneve 13 dhe 14 të Propozim Statutit, që kanë të bëjnë me qëllimet dhe me detyrat e Komisionit. Sipas mendimit të tyre, ekzistojnë çështje (siç është ajo e fatit të personave të zhdukur, e reparacioneve), të cilat nuk mund të zgjidhen brenda një shteti. Ata konsiderojnë se Komisioni rajonal është korniza më e mirë, se ka një potencial më të madh.

Në takimin tjetër, të mbajtur në datën 27.10.2013, në Zagreb, të dërguarit për KOMRA-n në mënyrë të hollësishme i kanë analizuar nenet nga shtatë kapituj të Propozim Statutit të KOMRA-s, dhe i kanë shprehur mendimet e tyre mbi autorizimet e KOMRA-s, zgjedhjen e paneleve selektuese, periudhën e veprimit dhe hulumtimit, çështjet e veçanta dhe të tjera me karakter terminologjik në lidhje me mundësitë juridike dhe kushtetuese për themelimin e KOMRA-s.<sup>64</sup>

Pas përfundimit të punës së Grupit Rajonal të Ekspertëve për KOMRA-n, Këshilli Rajonal i Koalicionit dhe avokuesit publik do të organizojnë kuvendin për KOMRA-n, që duhet të deklarohet mbi mendimin politik dhe ligjor të Grupit Rajonal të Ekspertëve për KOMRA-n dhe ndryshimet e Propozim Statutit.

## **5. Përkrahja ndërkombëtare**

Në deklaratën e përbashkët të datës 19. 03. 2013, delegacioni i Parlamentit Evropian dhe i Komitetit për Integritet Evropian i Republikës së Serbisë iu kanë bërë thirrje autoriteteve qeveritare të Republikës së Serbisë që të vazhdojnë për të përkrahur Nismën për KOMRA, si një mekanizëm i rëndësishëm i pajtimit, si dhe kryetarëve të shteteve të cilat ende nuk i kanë emëruar përfaqësuesit e tyre për KOMRA-n që ta bëjnë këtë menjëherë, në mënyrë që të fillonte procesi i themelimit formal të KOMRA-s.<sup>65</sup>

Komisioni Evropian (KE) në raportin mbi progresin e Serbisë në vitin 2013 e ka cekur se vazhdon me përkrahjen e procesit KOMRA. Në dokumentin Strategjia e zgjerimit dhe sfidat kyçe 2013 – 2014, të cilin e ka publikuar në datën 16 tetor të vitit 2013, KE e ka përshëndetur takimin e parë të të dërguarve kryetarëve të shteteve për KOMRA-n.

---

<sup>63</sup> <http://www.zarekom.org/vesti/Predsednik-Srbije-imenovao-sudiju-Sinisu-Vazica-za-licnog-izaslanika-za-REKOM.sr.html>

<sup>64</sup> Takimi i radhës është planifikuar për fillimin e muajit mars të vitit 2014, kur të dërguarit e KOMRA-s do të vazhdojnë me analizën e neneve të tjera të mbetura të Propozim Statutit të KOMRA-s.

<sup>65</sup> <http://www.zarekom.org/vesti/Delagacije-EP-i-Komiteta-za-evropske-integracije-Republike-Srbije-pozivaju-predsednike-drzava-u-regionu-da-otpocnu-proces-osnivanja-REKOM.sr.html>

## **6. Rritja e Koalicionit për KOMRA**

Në fund të muajit janar të vitit 2014, Koalicioni për KOMRA ka numëruar 1.982 anëtarë. Është fjala për Koalicion rajonal unik për drejtësinë tranzicionale, i cili zhvillon kapacitete që shteteve të rajonit të ish Jugosllavisë t'iu ndihmojë në krijimin e qasjes rajonale në ballafaqimin me të kaluarën, përkrahjen profesionale në formimin e KOMRA-s dhe përmbushjen e mandatit në vepër, që përbëhet nga regjistrimi i viktimave civile dhe ushtarake i kampeve të përqendrimit dhe i të burgosurve. E vështruar sipas shteteve, Koalicioni në Bosnjë e Hercegovinë numëron 407 anëtarë, në Mal të Zi 164, në Slloveni 50, në Kroaci 191, në Kosovë 404, në Maqedoni 72 dhe në Serbi 694 anëtarë.